

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Balla, Kryetar Kuvendi"/ Dalin MESAZHET! Si e informonte Vlora Hyseni-Ergys Agasin: O shpirt, do tak oј Kryeministrin...
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/23/balla-kryetar-kuvendi-dalin-mesazhet-si-e-informonte-vlor-a-hyseni-ergys-agasin-do-takoj-kryeministrin/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:50:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 11:42:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	626789dc9a624501c75b2806bf754fa96701095ee1b30dfcef244501ac0f7c81
TEKSTI	66032499b641bf2de9678bc9190c2e9b2632677f2ff7c4289bf1228bf49754d4
PAMJA	9e5a8c1a030881fa9f51dfef3c47133320025c37712e902707d015f94cccb689

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0ef4167da4c597613fb6b6d08f936af8afebbbee275a05b783a0d9eb00d94dc1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0ef4167da4c597613fb6b6d08f936af8afebbbee275a05b783a0d9eb00d94dc1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

“Balla, Kryetar Kuvendi”/ Dalin MESAZHET! Si e informonte Vlora Hyseni-Ergys Agasin: O shpirt, do takoj Kryeministrin...

13:42 : 23/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, KRYESORE, VIDEO



Janë zbardhur mesazhet **mes ish kreut të SHISH, Vlora Hyseni**, e cila dje u la në masën e sigurisë “arrest shtëpie”, **me biznesmenin Ergys Agasi**, i arrestuar disa javë më parë **për aferën e AKSHI-t** pas disa muajsh që ishte në arrati.

Gazetarja Klodiana Lala ka siguruar pjesë nga dosja e SPAK, ku tregohet se **ka pasur një lidhje personale dhe të vazhdueshme mes Hysenit dhe Agasit**. Hyseni, në shkelje të hapur me detyrën, raportonte te Agasi **për lëvizjet dhe takimet e saj të punës**.

Sipas SPAK, në komunikimet mes tyre, tregohet se Hyseni komunikonte me Agasin edhe gjatë kohës që ishte në kërkim nga drejtësia.

Në një bisedë mes tyre, Vlora Hyseni për njerëz, që sipas së cilës, iu kanë bërë shumë gjëra, por shton se do t'i bëjë që të paguajnë. Më pas, ajo i thotë se duhet të fokusohen në hallin e Agasit dhe se mund të përfundonin keq.

“Nga përmbajtja e komunikimeve mes tyre rezulton ekzistenca e një lidhjeje personale dhe e

TË GJITHA



9 faqet e SHISH në makinën e Agasit, bashkëpunim apo nxjerrje informacioni? Ku nis përgjegjësia penale?

20:42 : 23/09/2026



Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga “bossët” e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës

20:32 : 23/09/2026



Administrata Trump po përgatit planin për ndalimin 90-ditor të eksporteve të naftës

20:17 : 23/09/2026



Stresi dhe inflamacioni mund të dëmtojnë zemrën në heshtje

20:17 : 23/09/2026



Berisha përjashton bojkotin e Parlamentit: Do ishte në favor të Ramës

20:04 : 23/09/2026



Dosja e SHISH, Salianji: Shteti ka rënë në duart e bandave

19:55 : 23/09/2026



Haxhiu i ftoi në takim, familjarët e 4 ish-krerëve të UÇK-së refuzojnë: Pasi Kuvendi të marrë vendim për Hagën

19:47 : 23/09/2026

vazhdueshme, e cila ka vijuar edhe gjatë kohës kur shtetasi Ergys Agasi ka qenë i shpallur në kërkim nga drejtësia. Në disa prej komunikimeve, shtetasja Vlora Hyseni identifikohet drejtpërdrejt me interesat e Ergys Agasit kundrejt organeve të drejtësisë që po e ndiqnin penalisht, duke përdorur shprehje si;

Lexo edhe:

9 faqet e SHISH në makinën e Agasit, bashkëpunim apo nxjerrje informacioni? Ku nis përgjegjësia penale?

510 komunikime Hyseni-Agasi, Berisha: Pse ish-kreu i SHISH nuk u cilësua pjesë e grupit kriminal?

Krejt këta njerëz që na kanë bërë çka na kanë bërë dua që të paguajnë.” “Zemër, thjesht duhet të koncentrohemi te halli jot..

“Të gjithë ne.”

“Do përfundojmë keq, shpirt.”

Sipas dosjes hetimore, këto komunikime, të vlerësuara në tërësinë dhe në kronologjinë e tyre, tregojnë jo thjesht një lidhje personale, por identifikimin e shtetasës Vlora Hyseni me qëndrimin dhe interesat e personit nën hetim ndaj procedimit penal që zhvillohej kundër tij, si dhe gatishmërinë e saj për t'i qëndruar pranë e për ta ndihmuar gjatë kohës që ai ishte në kërkim, duke vënë kështu në dispozicion cilësinë e saj zyrtare dhe kapacitetet institucionale që drejton.

Në këtë linjë veprimi ajo shpreh jo vetëm solidaritet, por edhe gatishmërinë për ta ndihmuar. Në një bisedë mes tyre, para arrestimit të shtetasit Ergys Agasi, ajo i shkruan këtë mesazh: “Zemër thjesht duhet të koncentrohemi te halli jot Të gjithë ne.

Shtetasja Vlora Hyseni nga numri +38***** i dërgon mesazhin “Çfarë na bene o Zot”. Po kështu në vijim të komunikimeve, në shkelje të rëndë të detyrës, Vlora Hyseni, tregon se do të takohet me Kryeministrin dhe sa kohë do rrijë tek ai. “Po me presin me shku te km.... Jo mo zemer une nje ore nuk rri me shume me ate”.

Më datë 24.08 2026

Solidarizimi me personin në kërkim Ergys Agasi pasqyrohet edhe në mesazhet e datës 22.08.2026 ku Vlora Hyseni i shkruan: “Sa sh gjëra na kanë bërë ne.... Te gjitha shpirt... O shpirt. Kjo është një situatë që do ja hedhim... Problemi është koha... Sa konsistencë kemi.”.

Në vijim të komunikimeve, shtetasja Vlora Hyseni ndan dhe informacion paraprak duke i shkruar personit nën hetim Ergys Agasi; “Taulant Balla kryetar Kuvendi.... Kështu janë infot... Bela me Taon shoku” (nënkuptohet deputeti Taulant Balla dhe deputetja Belinda Balluku).”, thuhet në dosjen hetimore.

LEXO EDHE:

Etiketa: Ergys Agasi hetime spak vlora hyseni

Lajme të lidhura



9 faqet e SHISH në makinën e Agasit, bashkëpunim apo nxjerrje informacioni? Ku nis përgjegjësia penale?

20:42 : 23/09/2026



510 komunikime Hyseni-Agasi, Berisha: Pse ish-kreu i SHISH nuk u cilësua pjesë e grupit kriminal?

18:53 : 23/09/2026



16 vite nga zhdukja misterioze e Bleona Matës, SPAK: Nuk kemi dosje të...

18:39 : 23/09/2026




E përfshirë në dosjen e Ergys Agasit/ Ish drejtoresha e SHISH, Vlora Hyseni nesër para GJKKO

16:48 : 23/09/2026



Berisha: Rama e ka përdorur Vlora Hysenin për të rrëzuar qeverinë në Kosovë

14:23 : 23/09/2026



Mbi 500 telefonata e mesazhe mes Hysenit dhe Agasit/ Si ranë në duart e hetuesve përgjimet e forta



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.